



# FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

[www.qpz.gov.al](http://www.qpz.gov.al)

**Nr.158**

**2 dhjetor**

**2011**

## P Ë R M B A J T J A

		Faqe
Dekret nr.7151 datë 10.11.2011	Për dhënie të shtetësisë shqiptare.....	7553
Dekret nr.7158 datë 14.11.2011	Për dhënie të shtetësisë shqiptare.....	7554
Vendim i KM nr.769, datë 4.11.2011	Për një shtesë fondi në buxhetin e vitit 2011, miratuar për Kryeministrinë.....	7554
Vendim i KM nr.770, datë 10.11.2011	Për transferimin e truallit me sipërfaqe 85 000 m <sup>2</sup> , në fshatin Mëzez, në kthesën e Kamzës, Tiranë, në pronësi të Bashkisë së Tiranës.....	7555
Vendim i KM nr.771, datë 10.11.2011	Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga zgjerimi dhe rikonstruksioni i pikës kufitare Morinë-Kukës.....	7555
Vendim i KM nr.775, datë 2.11.2011	Për licencimin e institucionit të arsimit të lartë privat “Akademia e Ndërtimit e Tiranës”, Tiranë.....	7557
Vendim i KM nr.777, datë 10.11.2011	Për shpalljen e vitit të 100 - vjetorit të Pavarësisë së Shqipërisë...	7559
Vendim i KM nr.778, datë 10.11.2011	Për lejimin e Shërbimit Informativ të Shtetit, si autoritet kontraktor, për të kryer procedurën e prokurimit, me objekt “Blerje pjesësh ndërrimi, për shërbime profilaktike, gomash dhe lubrifikantësh për automjete”.....	7559
Vendim i KM nr.779, datë 10.11.2011	Për një ndryshim në vendimin nr.472, datë 2.7.2011 të Këshillit të Ministrave “Për disiplinimin e përdorimit të fondeve buxhetore, për vitin 2011”, të ndryshuar.....	7560

Vendim i KM nr.780, datë 10.11.2011	Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr.804, datë 21.11.2007 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullores së personelit të Policisë së Shtetit”.....	7560
Vendim i KM nr.807, datë 30.11.2011	Për shpallje ditë zie kombëtare.....	7562
Vendim i KM nr.808, datë 30.11.2011	Për organizimin e ceremonisë funebre shtetërore në nderim të të ndjerit Leka ZOGU I (pretendent i Fronit Mbretëror të Shqiptarëve).....	7562
Urdhër i KM nr.100, datë 16.11.2011	Për identifikimin e akteve administrative të tipit “Autorizim”, që lëshohen nga ministrat dhe titullarët e institucioneve qendrore.....	7563
	Vendim (i shkurtuar) për shpalljen të vdekur të shtetasit Koço Dado.....	7564

**DEKRET**  
**Nr.7151, datë 10.11.2011**

**PËR DHËNIE TË SHTETËSISË SHQIPTARE**

Në mbështetje të nenit 92 pika “c” dhe nenit 93 të Kushtetutës, të nenit 9 dhe të nenit 20 të ligjit nr.8389, datë 5.8.1998 “Për shtetësinë shqiptare”, të ndryshuar, bazuar edhe në propozimin e Ministrisë të Brendshme,

**DEKRETOJ:**

**Neni 1**

I jepet shtetësia shqiptare me kërkesë të tyre personave të mëposhtëm:

1. Tamer Silman Duymaz
2. Halil Mehmet Gök
3. Fatih Ufuk Mustafa Bağcı
4. İlhan Veli Sarıkaya
5. Katerina (Kateryna) Andrij Kongoli (Fedina)
6. Kujtim Liman Siriniqi
7. Mehmet Ali Aslan
8. Besjan Nexhmedin Canhasi
9. Arif Hadi Asani
10. Arian Nexhat Ballanca
11. Kaan Ahmet Pekin
12. Alp Yavuz Kaan Pekin
13. Ibrahim Mustafa Taşkin
14. Fatih Nazim Karaosmanoğlu
15. Nimetullah Hakki İkikardeş
16. Tonja Nreca Tushi
17. Sandra Patricia Hernando Spahiu (Marquez Neira)
18. Jehona Salami Varfi (Roka)
19. Jolanda Asllan Maqellara (Maqellari)
20. Petrit Asllan Maqellara (Maqellari)
21. Ylli Asllan Maqellara (Maqellari)

**Neni 2**

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

**PRESIDENTI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**  
**Bamir Topi**



**DEKRET**  
**Nr.7158, datë 14.11.2011**

**PËR DHËNIE TË SHTETËSISË SHQIPTARE**

Në mbështetje të nenit 92 pika “c” dhe nenit 93 të Kushtetutës, të nenit 9, pika 7 dhe të nenit 20 të ligjit nr.8389, datë 5.8.1998 “Për shtetësinë shqiptare”, të ndryshuar, bazuar në propozimin e Ministrisë të Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta,

**DEKRETOJ:**

**Neni 1**

I jepet shtetësia shqiptare me kërkesë të tij personit të mëposhtëm:

Daniela Gaetano Zampini

**Neni 2**

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

**PRESIDENTI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**  
**Bamir Topi**

**VENDIM**  
**Nr.769, datë 4.11.2011**

**PËR NJË SHITESË FONDI NË BUXHETIN E VITIT 2011,**  
**MIRATUAR PËR KRYEMINISTRINË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5 e 45 të ligjit nr.9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” dhe të nenit 13 të ligjit nr.10 355, datë 2.12.2010 “Për buxhetin e vitit 2011”, të ndryshuar, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Kryeministrisë, në buxhetin e miratuar për vitin 2011, zëri “Investime”, t’i shtohet fondi prej 10 000 000 (dhjetë milionë) lekësh, për përballimin e shpenzimeve për blerje ashensori.
  2. Ky fond të përballohet nga fondi rezervë i Këshillit të Ministrave.
  3. Ngarkohen Ministria e Financave dhe Kryeministria për zbatimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYEMINISTRI**  
**Sali Berisha**

**VENDIM**  
**Nr.770, datë 10.11.2011**

**PËR TRANSFERIMIN E TRUALLIT ME SIPËRFAQE 85 000 M<sup>2</sup>, NË FSHATIN MËZEZ,  
NË KTHESËN E KAMZËS, TIRANË, NË PRONËSI TË BASHKISË SË TIRANËS**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 3, 5, 8 e 17 të ligjit nr.8744, datë 22.2.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, të ndryshuar, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Transferimin e truallit me sipërfaqe 85 000 (tetëdhjetë e pesë mijë) m<sup>2</sup>, me nr.parcele 68, në zonën kadastrale 2 679, në fshatin Mëzez, të regjistruar në vëllimin 4, faqe 161, zona kadastrale 2 697, ndodhur në kthesën e Kamzës, Tiranë, aktualisht në përgjegjësi administrimi të Ministrisë së Financave, në pronësi të Bashkisë së Tiranës.
  2. Çdo procedurë administrative e nisur dhe që ka lidhje me pronën, objekt i këtij vendimi, ndërpritet.
  3. Prona është e destinuar të përdoret për ndërtimin e Terminalit Multimodal të Pasagjerëve.
  4. Vendimi nr.970, datë 30.9.2009 i Këshillit të Ministrave “Për ndryshimin e përgjegjësisë së administrimit, nga Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit Ministrisë së Financave, të një sipërfaqeje trualli, në kthesën e Kamzës, Tiranë”, shfuqizohet.
  5. Ngarkohen kryetari i Bashkisë së Tiranës, Ministria e Financave dhe kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë për zbatimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI**  
**Sali Berisha**

**V ENDIM**  
**Nr.771, datë 10.11.2011**

**PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE TË  
PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA ZGJERIMI  
DHE RIKONSTRUKSIONI I PIKËS KUFITARE MORINË-KUKËS**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5, pika 1, 20 e 21 të ligjit nr.8561, datë 22.12.1999 “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik” dhe të ligjit nr.10 355, datë 2.12.2010 “Për buxhetin e vitit 2011”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga zgjerimi dhe rikonstruksioni i pikës kufitare Morinë - Kukës.
2. Shpronësimi të bëhet në favor të Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave.



3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, që shpronësohen, të kompensohen në vlerë të plotë, sipas masës përkatëse që paraqitet në tabelën bashkëlidhur këtij vendimi, për sipërfaqen, tokë arë, prej 8410 (tetë mijë e katërqind e dhjetë) m<sup>2</sup>, me vlerë 1 404 470 (një milion e katërqind e katër mijë e katërqind e shtatëdhjetë) lekë, për truallin, me sipërfaqe 1250 (një mijë e dyqind e pesëdhjetë) m<sup>2</sup>, me vlerë 1 338 855 (një milion e treqind e tridhjetë e tetë mijë e tetëqind e pesëdhjetë e pesë) lekë, për objekt, me vlerë 5 322 689.36 (pesë milionë e treqind e njëzet e dy mijë e gjashtëqind e tetëdhjetë e nëntë pikë tridhjetë e gjashtë) lekë, me një vlerë të përgjithshme shpronësimi prej 8 060 014.36 (tetë milionë e gjashtëdhjetë mijë e katërmëdhjetë pikë tridhjetë e gjashtë) lekësh.

4. Shpenzimet procedurale të përballohen nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave.

5. Vlera e përgjithshme e shpronësimit, prej 8 060 014.36 (tetë milionë e gjashtëdhjetë mijë e katërmëdhjetë pikë tridhjetë e gjashtë) lekësh, të përballohet nga fondet e programuara në buxhetin e Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave.

6. Pronarët e pasurisë, për të cilën është bërë shënimi “Konfirmuar nga ZVRPP-ja”, të kompensohen, për efekt shpronësimi, në bazë të dokumentacionit të pronësisë, si dhe atij tekniko-ligjor.

7. Pronarët e përmendur në listën, që i bashkëlidhet këtij vendimi, për të cilët është bërë shënimi “I pakonfirmuar nga ZVRPP-ja”, të kompensohen, për efekt shpronësimi, pasi të kenë paraqitur dokumentacionin e plotë të pronësisë pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave.

8. Drejtoria e Përgjithshme e Doganave të kryejë likuidimin e pronarëve të pasurive, për të cilat janë bërë shënimet përkatëse “Konfirmuar nga ZVRPP-ja” dhe “I pakonfirmuar nga ZVRPP-ja”, në bazë të pikave 6 dhe 7 të këtij vendimi.

9. Brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e miratimit të këtij vendimi, Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme dhe Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, Kukës, në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave, të fillojnë procedurat për të bërë kalimin e pronësisë për pasuritë e shpronësuara në favor të shtetit.

10. Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme dhe Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, Kukës, të pezullojnë të gjitha transaksionet me pasuritë e shpronësuara, deri në çastin kur do të realizohet procesi i kalimit të pronësisë për pasuritë e shpronësuara.

11. Ngarkohen Ministria e Financave, Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme dhe Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, Kukës, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI**  
**Sali Berisha**

**LISTA E PRONARËVE QË SHPRONËSOHEN SI REZULTAT E ZGJERIMIT DHE  
RIKONSTRUKSIONIT TË PIKËS KUFITARE MORINË-KUKËS**

Lloji i pasurisë: tokë arë  
Fshati Morinë, Z.K.2724

Pronari			Z.K.	Nr. pasurisë	Tokë arë			Shënime
Emri	Atësia	Mbiemri			Sip. m <sup>2</sup>	Çmimi lekë m <sup>2</sup>	Vlera lekë	
Rive	Iljaz	Duraku	2724	83/8	4839	167	808113	Konfirmuar nga ZVRPP
Kujtim	Islam	Duraku	2724	82/8/9	2856	167	476952	Konfirmuar nga ZVRPP
Kujtim	Islam	Duraku			299	167	49933	E pakonfirmuar nga ZVRPP
Gjemshit	Shaqir	Duraku	2724	83/12	416	167	69472	Konfirmuar nga ZVRPP
	<b>Totali</b>						<b>1404470</b>	

Lloji i pasurisë: truall  
Fshati Morinë, Z.K.2724

Pronari			Z.K.	Nr. pasurisë	Tokë arë (bashkëpronarë)			Shënime
Emri	Atësia	Mbiemri			Sip. m <sup>2</sup>	Çmimi lekë m <sup>2</sup>	Vlera lekë	
Rive	Iljaz	Duraku	2724	83/5	416.7	1071	446285	Konfirmuar nga ZVRPP
Kujtim	Islam	Duraku	2724	83/5	416.6	1071	446285	Konfirmuar nga ZVRPP
Ylber	Islam	Duraku	2724	83/5	416.7	1071	446285	Konfirmuar nga ZVRPP
	<b>Totali</b>						<b>1338855</b>	

Lloji i pasurisë: godina  
Fshati Morinë, Z.K.2724  
Lloji i pasurisë: objekt

Pronari			Z.K.	Nr. pasurisë	Tokë arë (bashkëpronarë)			Shënime
Emri	Atësia	Mbiemri			Sip. m <sup>2</sup>	Çmimi lekë m <sup>2</sup>	Vlera lekë	
Rive	Iljaz	Duraku	2724	83/5	83.8166	21168	1774229.7888	Konfirmuar nga ZVRPP
Kujtim	Islam	Duraku	2724	83/5	83.8166	21168	1774229.7888	Konfirmuar nga ZVRPP
Ylber	Islam	Duraku	2724	83/5	83.8166	21168	1774229.7888	Konfirmuar nga ZVRPP
	<b>Totali</b>						<b>5322689.3664</b>	

**VENDIM  
Nr.775, datë 2.11.2011**

**PËR LICENCIMIN E INSTITUCIONIT TË ARSIMIT TË LARTË PRIVAT “AKADEMIA E  
NDËRTIMIT E TIRANËS”, TIRANË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 4, pika 2, 43, 44 e 45 të ligjit nr.9741, datë 21.5.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrisë të Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave



## VENDOSI:

1. Licencimin e institucionit të arsimit të lartë privat “Akademia e Ndërtimit e Tiranës”, Tiranë, në emër të shoqërisë “Akademia e Ndërtimit e Tiranës”, sh.p.k., e cila do ta ushtrojë veprimtarinë në qytetin e Tiranës.

2. “Akademia e Ndërtimit e Tiranës”, Tiranë, të organizohet në dy fakultete:

a) Fakulteti i Inxhinierisë së Ndërtimit dhe Hidroteknikës, i cili do të ofrojë programe studimi të ciklit të parë, në përfundim të të cilave lëshohet diplomë universitare “Bachelor” në:

- i) Inxhinieri ndërtimi;
- ii) Inxhinieri hidroteknike.

b) Fakulteti i Studimeve Profesionale, i cili do të ofrojë programe studimi jouniversitare profesionale, që përfundojnë me diplomë profesionale, me profile në:

- i) Ndërtim;
- ii) Arkitekturë.

3. “Akademia e Ndërtimit e Tiranës”, Tiranë, do të ofrojë programe studimi të ciklit të parë, me kohë të plotë, me kohëzgjatje normale 3 (tri) vite akademike dhe që realizohen me 180 kredite, në përfundim të të cilave lëshohet diplomë universitare “Bachelor”, në:

- a) Inxhinieri ndërtimi;
- b) Inxhinieri hidroteknike.

4. “Akademia e Ndërtimit e Tiranës”, Tiranë, do të ofrojë programe studimi jouniversitare, profesionale, pas arsimit të mesëm, me kohë të plotë, me kohëzgjatje normale jo më pak se 2 (dy) vite akademike, me jo më pak se 120 kredite dhe në përfundim të tij lëshohet diplomë profesionale, me profile:

- a) Ndihmësinxhinier në ndërtim;
- b) Ndihmësinxhinier në arkitekturë.

5. “Akademia e Ndërtimit e Tiranës”, Tiranë, ta fillojë veprimtarinë mësimore për programet e studimit, të përcaktuara në pikat 2 dhe 3 të këtij vendimi, pasi të ketë marrë, jo më vonë se tri javë para fillimit të vitit akademik, lejen përkatëse nga Ministri i Arsimit dhe Shkencës. Ministri e lëshon lejen, pasi vlerëson se institucioni privat i arsimit të lartë ka përmbushur angazhimet e deklaruara, në përputhje me udhëzimin e tij për këtë qëllim.

6. Ndryshimet në vendndodhje, plane, forma studimi dhe programe, si dhe në elemente të tjera, të miratuara, bëhen pas miratimit nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës.

7. “Akademia e Ndërtimit e Tiranës”, Tiranë, duhet t'i nënshtrohet procesit të akreditimit institucional dhe të programeve të studimit, brenda afateve të përcaktuara në ligjin në fuqi.

8. Ngarkohet Ministria e Arsimit dhe Shkencës për kontrollin periodik të ligjshmërisë në institucion dhe për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI**  
**Sali Berisha**



**VENDIM**  
**Nr.777, datë 10.11.2011**

**PËR SHPALLJEN E VITIT TË 100 - VJETORIT TË PAVARËSISË SË SHQIPËRISË**

Në mbështetje të neneve 95, pika 2, dhe 100 të Kushtetutës, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

Periodha 28 nëntor 2011 deri 28 nëntor 2012 të shpallet “Viti i 100 - vjetorit të Pavarësisë së Shqipërisë”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletore Zyrtare.

**KRYEMINISTRI**  
**Sali Berisha**

**VENDIM**  
**Nr.778, datë 10.11.2011**

**PËR LEJIMIN E SHËRBIMIT INFORMATIV TË SHETIT, SI AUTORITET  
KONTRAKTOR, PËR TË KRYER PROCEDURËN E PROKURIMIT, ME OBJEKT  
“BLERJE PJESËSH NDËRRIMI, PËR SHËRBIME PROFILAKTIKE, GOMASH DHE  
LUBRIFIKANTËSH PËR AUTOMJETE”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar, të ligjit nr.9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” dhe të ligjit nr.10 355, datë 2.12.2010 “Për buxhetin e vitit 2011”, të ndryshuar, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Lejimin e Shërbimit Informativ të Shtetit, si autoritet kontraktor, për të kryer procedurën e prokurimit, me objekt “Blerje pjesësh ndërrimi, për shërbime profilaktike, gomash dhe lubrifikantësh për automjete”, si dhe për të lidhur kontratat përkatëse, brenda datës 15.12.2011.

2. Ngarkohen Ministria e Financave, Shërbimi Informativ i Shtetit dhe Agjencia e Prokurimit Publik për ndjekjen e zbatimit të këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletore Zyrtare.

**KRYEMINISTRI**  
**Sali Berisha**



**VENDIM**  
**Nr.779, datë 10.11.2011**

**PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR.472, DATË 2.7.2011 TË KËSHILLIT TË  
MINISTRAVE “PËR DISIPLINIMIN E PËRDORIMIT TË FONDEVE BUXHETORE,  
PËR VITIN 2011”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 16 e 40 të ligjit nr.9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” dhe të nenit 10 të ligjit nr.10 355, datë 2.12.2010 “Për buxhetin e vitit 2011”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Shkronja “a” e pikës 1 të vendimit nr.472, datë 2.7.2011 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, shfuqizohet.

2. Ngarkohen të gjitha institucionet e njësisë të qeverisjes së përgjithshme për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI**  
**Sali Berisha**

**VENDIM**  
**Nr.780, datë 10.11.2011**

**PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË VENDIMIN NR.804, DATË 21.11.2007 TË  
KËSHILLIT TË MINISTRAVE “PËR MIRATIMIN E RREGULLORES SË PERSONELIT  
TË POLICISË SË SHTETIT”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 41, 86, e 129 të ligjit nr.9749, datë 4.6.2007 “Për Policinë e Shtetit”, të ndryshuar, dhe të pikave 1 e 2 të nenit 8, të ligjit nr.9970, datë 24.7.2008 “Për barazinë gjinore në shoqëri”, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

Në rregulloren e miratuar me vendimin nr.804, datë 21.11.2007 të Këshillit të Ministrave, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

1. Shkronja “d” e nenit 7, ndryshohet, si më poshtë vijon:

“ d) fotokopje të dëshmisë së aftësisë së drejtimit të automjetit të tipit B, e cila, për gjininë më pak të përfaqësuar, mund të paraqitet në një afat kohor deri në 12 (dymbëdhjetë) muaj pas fillimit të shkollës bazë të policisë. Nëse aplikantët nuk e paraqesin këtë dokument brenda 12 (dymbëdhjetë) muajve, lirohen nga Policia e Shtetit;”.

2. Në nenin 19 bëhen ndryshimet dhe shtesa e mëposhtme:

a) Pikat 2 dhe 3 ndryshohen, si më poshtë vijon:

“2. Aplikantët renditen në listën përfundimtare, sipas rezultateve të arritura dhe gjinisë. Kjo listë shpallet publikisht, jo më vonë se të nesërmen e ditës së përfundimit të procesit të intervistimit me gojë.

3. Në varësi të vendeve të lira në Policinë e Shtetit, kandidatët, që do të përzgjidhen, bazuar në listën e rezultateve të arritura sipas rendit zbritës dhe gjinisë, kanë të drejtë të vazhdojnë procedurat e mëtejshme të testimit, sipas nenit 13 të kësaj rregulloreje.”.

b) Pas pikës 3 shtohet pika 4, me këtë përmbajtje:

“4. Minimalisht 50% e kandidatëve që pranohen në polici të jenë nga gjinia më pak e përfaqësuar. Kur në listën respektive nuk ka kandidatë të mjaftueshëm për të plotësuar këtë kuotë, atëherë realizohet një fushatë e re pranimi vetëm për gjininë e nënpërfaqësuar.”.

3. Në nenin 50 bëhen këto shtesa e ndryshime:

a) Në pikën 2 bëhen shtesat dhe ndryshimet e mëposhtme:

- Pas nënndarjes “iv” të shkronjës “a”, shtohet nënndarja “v”, me këtë përmbajtje:

“v. Të ketë përfunduar shkollën bazë të policisë.”.

- Nënndarja “iii” e shkronjës “b”, ndryshohet, si më poshtë vijon:

“iii) Të shpallet fitues në testin me shkrim, intervistën me gojë, si dhe ushtrimet vlerësuese.”.

- Nënndarja “iii” e shkronjës “c”, ndryshohet, si më poshtë vijon:

“iii) Të shpallet fitues në testin me shkrim, intervistën me nivelin drejtues, si dhe ushtrimet vlerësuese.”.

b) Nënndarja “iii” e shkronjës “a”, të pikës 3, ndryshohet, si më poshtë vijon:

“iii) Të shpallet fitues në testin me shkrim, ushtrimet vlerësuese, si dhe në intervistën me nivelin drejtues.”.

4. Shkronja “dh” e pikës 2, të nenit 53, ndryshohet, si më poshtë vijon:

“dh) Vlera e rezultatit të testit me shkrim, si dhe e rezultateve të fazave të tjera të testimit në raport me rezultatin e përgjithshëm të kandidatit përcaktohet nga drejtori i Përgjithshëm i Policisë. Rezultati i testit me shkrim, në asnjë rast, nuk mund të përbëjë më pak se 60 % të rezultatit të përgjithshëm të kandidatit.”.

5. Në nenin 54 bëhen këto ndryshime:

a) Pika 2 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“2. Kandidatët, që kalojnë testin me shkrim për ngritjen në grada, nga “Kryeinspektor” deri në “Drejtues”, ose ushtrimet vlerësuese për ngritjen në grada, nga “Kryekomisar” deri në “Drejtues i parë”, njoftohen të marrin pjesë në një proces vlerësimi për:”.

b) Në fund të pikës 4 shtohet fjalia, me këtë përmbajtje:

“Në përbërjen e komisioneve të vlerësimit mund të caktohen dhe persona, jashtë strukturave të Policisë së Shtetit.”.

c) Fjalia e fundit e pikës 5 shfuqizohet.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI  
Sali Berisha



**VENDIM**  
**Nr.807, datë 30.11.2011**

**PËR SHPALLJE DITË ZIE KOMBËTARE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 4 të nenit 4 të ligjit nr.8926, datë 22.7.2002 “Për formën dhe përmasat e flamurit kombëtar, përmbajtjen e himnit kombëtar, formën dhe përmasat e stemës së Republikës së Shqipërisë dhe mënyrën e përdorimit të tyre”, si dhe të pikës 8 të kreut VI të Ceremonialit Zyrtar të Republikës së Shqipërisë, miratuar me vendimin nr.229, datë 23.4.2004 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Shpalljen ditë zie kombëtare të datës 3 dhjetor 2011, ditë e zhvillimit të ceremonisë funebre shtetërore, në nderim të të ndjerit Leka ZOGU I (pretendent i Fronit Mbretëror të Shqiptarëve).

2. Në të gjitha institucionet, shtetërore dhe publike, të ulet flamuri kombëtar në gjysmë shtize dhe në orën 12.00 të mbahet një minutë heshtje.

3. Radio-Televizioni Publik Shqiptar, gjatë zhvillimit të ceremonialit, të transmetojë muzikë funebre.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYEMINISTRI**  
**Sali Berisha**

**VENDIM**  
**Nr.808, datë 30.11.2011**

**PËR ORGANIZIMIN E CEREMONISË FUNEBRE SHTETËRORE, NË NDERIM TË TË NDJERIT LEKA ZOGU I (PRETENDENT I FRONIT MBRETËROR TË SHQIPTARËVE)**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës të ligjit nr.10 355, datë 2.12.2010 “Për buxhetin e vitit 2011”, të ndryshuar, dhe të pikës 10 të kreut VII të Ceremonialit Zyrtar të Republikës së Shqipërisë, miratuar me vendimin nr.229, datë 23.4.2004 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Organizimin e ceremonisë funebre shtetërore, në nderim të të ndjerit Leka ZOGU I (pretendent i Fronit Mbretëror të Shqiptarëve), i cili, pas një sëmundjeje të rëndë, ndërroi jetë në datën 30.11.2011.

2. Ngritjen e komisionit shtetëror për kryerjen e ceremonisë funebre shtetërore, në përbërje të të cilit të jenë:

- z. Edmond Haxhinasto, Zëvendëskryeministër dhe Ministër i Punëve të Jashtme;
- z. Aldo Bumçi, Ministër i Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve;

- z. Arben Imami Ministër i Mbrojtjes;
- Një përfaqësues i Oborrit Mbretëror Shqiptar;
- Një përfaqësues i protokollit të Shtetit;
- Një përfaqësues i protokollit të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë.

3. Ceremonia e homazheve të organizohet ditën e shtunë, datë 3.12.2011, ora 10.00 deri 12.00, në mjediset e sallës së seancave plenare të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë.

4. Shpenzimet e varrimit dhe të ceremonialit të përballohen nga buxheti i vitit 2011, miratuar për Ministrinë e Punëve të Jashtme.

5. Ngarkohet Ministria e Punëve të Jashtme për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI  
Sali Berisha

**URDHËR**  
**Nr.100, datë 16.11.2011**

**PËR IDENTIFIKIMIN E AKTEVE ADMINISTRATIVE TË TIPIT “AUTORIZIM”, QË  
LËSHOHEN NGA MINISTRAT DHE TITULLARËT E INSTITUCIONEVE QENDRORE**

Në mbështetje të pikës 3 të nenit 102 të Kushtetutës,

**URDHËROJ:**

1. Të gjitha ministrinë dhe institucionet qendrore të dërgojnë në Ministrinë e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, brenda datës 30.11.2011, informacionin e nevojshëm, si më poshtë vijon:

a) Listën me të gjitha llojet e autorizimeve, të cilat nuk kalojnë nëpërmjet Qendrës Kombëtare të Licencimit (QKL), të lëshuara nga ministrat dhe titullarët e institucioneve qendrore, sipas legjislacionit në fuqi, në përmbushje të veprimtarisë së tyre funksionale, për subjektet e ndryshme tregtare, që operojnë në Republikën e Shqipërisë.

b) Të dhëna për bazën ligjore përkatëse, nga ligji deri tek udhëzimet, si dhe për kriteret e formularët e aplikimeve.

c) Listën me të gjitha subjektet e identifikuar, llojin e autorizimeve, sipas fushës së veprimtarive dhe me afatet e vlefshmërisë së tyre, etj., me të cilat këto subjekte janë pajisur për vitet 2009, 2010 dhe 2011.

2. Ngarkohet Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, që, në bashkëpunim me institucionet përkatëse, në përmbushje të detyrave të Taks Forcës Rregullatore, të hartojë propozime konkrete për eliminimin, thjeshtimin dhe futjen e autorizimeve, brenda trajtimit të institucionit të QKL-së.

3. Ngarkohen të gjitha ministrinë dhe institucionet qendrore për zbatimin e këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI  
Sali Berisha



**VENDIM**  
(i shkurtuar)

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr.8129, datë 20.10.2011, vendosi shpalljen të vdekur të shtetasit Koço Dado, i biri i Mistos dhe i Aleksandrës, lindur më 13.3.1949.

**Abonimet vjetore për Fletoren Zyrtare mund të bëhen pranë Postës Shqiptare ose pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare, në adresën: Bulevardi “Gjergj Fishta”, mbrapa ish-eksponitës “Shqipëria Sot”, tel: 04 24 27 007.**  
Çmimi i abonimit pranë Postës Shqiptare, për Fletoret Zyrtare 2011, është 16 000 lekë.  
Çmimi i abonimit në QPZ është 14 000 lekë pa detyrimin e shpërndarjes në adresa.

## BOTIMET E QENDRËS SË PUBLIKIMEVE ZYRTARE

KODI CIVIL	360 lekë
KODI I FAMILJES	310 lekë
KODI I PROCEDURAVE ADMINISTRATIVE	90 lekë
KODI PENAL USHTARAK	55 lekë
KODI I PUNËS	140 lekë
KANONI I ZHURISË	40 lekë
PËRMBLEDHJE E VENDIMEVE TË GJYKATËS EUROPIANE	328 lekë
PËR TË DREJTAT E NJERIUT KUNDËR SHQIPËRISË	
PËRMBLEDHJE PËR KTHIMIN DHE KOMPENSIMIN E PRONAVE	140 lekë
PËRMBLEDHJE VENDIMESH UNIFIKUESE TË GJYKATËS SË LARTË	512 lekë

Hyri në shtyp më 1.12.2011  
Doli nga shtypi më 2.12.2011

Tirazhi: 1700 copë

Formati: 61x86/8

Shtypshkronja e Qendrës së Publikimeve Zyrtare  
Tiranë, 2011

Çmimi 16 lekë